



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT

KORÇË

VENDIM

Nr 45 Datë 18.07.07

PËR

MIRATIM FONDI PËR INSTALIMIN E RRJETIT
KOMPJUTERIK, INTERNETIT (ADSL), CENTRALIT
TELEFONIK DHE VENDOSJES SË TELEFONIT PA PAGESË
PËR QYTETARËT

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, për "PËR MIRATIM FONDI PËR INSTALIMIN E RRJETIT KOMPJUTERIK, INTERNETIT (ADSL), CENTRALIT TELEFONIK DHE VENDOSJES SË TELEFONIT PA PAGESË PËR QYTETARËT", bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligjin nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 të M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë fondin total prej 899.200 lekë për vendosjen e centralit telefonik, instalimit të rrjetit kompjuterik, linjës së internetit dhe vendosjen e telefonit pa pagesë në shërbim të qytetarëve si më poshtë :

1. Centrali telefonik (pajisje dhe shpenzimet instaluese të telekomunikacionit)	390.000 lekë
2. Instalimi i rrjetit kompjuterik	350.000 lekë
3. Interneti(Instalimi i sistemit të kompjuterizuar)	80.000 lekë
4. Kostoja e instalimit të telefonit pa pagesë 0800-xxxx	79.200 lekë
TOTALI	899.200 lekë

2. Kostoja e telefonit pa pagesë 0800-xxxx për qytetarët do të përballohet nga fondi i shpenzimeve operative të Bashkisë për vitin 2007 në zërin (abonim internet ADSL), duke e pakësuar këtë zë për vlerën 79.200 lekë si më poshtë:

Nr	Emertimi	Fondi i planifikuar	Ndryshimet		Fondi i ndryshuar
			Pakesime	Shtesa	
1	Abonim internet ADSL	224.000	79.200		144.800
2	Kostoja e telefonit pa pagesë			79.200	79.200

3. Shpenzimet për centralin telefonik, instalimin e rrjetit kompjuterik dhe instalimi i sistemit të kompjuterave do të përballohen nga fondi i kursyer nga tenderi “Ruajtja e objekteve të Bashkisë për vitin 2007”, me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet	00.	01110	05	Art. 6022008	- 820.000 lekë
Shtohet	00.	01110	05	Art. 2314110	+390.000 lekë
Shtohet	00.	01110	05	Art. 2313500	+350.000 lekë
Shtohet	00.	01110	05	Art. 2314160	+ 80.000 lekë

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Personelit, Protokoll-Arkivës dhe Mbështetjes në Bashki.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE

Raimonda NASE